

## AKT THEMELIMI

### I

## SHOQËRISË

### GO GREEN POÇEM SH.P.K.

Sot, më 19.05.2022, **Z. Dritan Skënderaj**, shtetas shqiptar, lindur më 14/04/1982, në Ninësh, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I20414130E (më poshtë referuar bashkërisht si "**Ortaku i Vetëm**" ose "**Ortaku**"), vendos mbi këtë Akt Themelimi, si më poshtë:

#### I. Themelimi

**Ortaku i Vetëm** deklaron krijimin dhe themelimin e një shoqërie shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, **Go Green Poçem Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "**Shoqëria**"), në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("**Ligji Tregtar**"). Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pakufizuar.

#### II. Selia e regjistruar e Shoqërisë

Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Rrugën Budi, Apartamenti nr. 3, Tiranë – Shqipëri, Pasuria nr. 4/716+1-3, Kodi Unik 8160017067, Zona Kadastrale 8160.


#### III. Objekti

1. Objekti i Shoqërisë, do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

- Aktivitetet e lidhura me energjinë diellore dhe energjinë e rinovueshme;
- Projektimi, ndërtimi, instalimi, komisionimi, finacimi, operimi, përmirësimi, dhe mirëmbajtja e centralit të prodhimit të energjisë nga dielli dhe infrastrukturës shërbyese, përfshirë panelet fotovoltaike të ndodhura në Poçem - Kutë, Fier;
- Prodhimi dhe Gjenerimi i energjisë diellore;
- Zhvillimi i Ndërtimit, Operimi, Inxhinieria, Prokurimi i panelve fotovoltaike gjenerues;
- Furnizimi me energji elektrike, shpërndarja dhe shitja e saj;
- Tregti dhe shitja e energjisë me shumicë;
- Importi dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe aktiviteteve;
- Çdo dhe të gjitha aktivitetet e tjera të lejuara nga ligji shqiptar, duke përfshirë të gjitha mallrat dhe shërbimet.

2. Në përputhje me legjislacionin shqiptar për përmbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria mund:

- (i) të marrë licencat dhe autorizimet përkatëse dhe të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qira, apo hipotekore, të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;
- (ii) të blejë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, interesa në shoqëri të tjera, të cilat kanë një objekt (fushë veprimtarie) të ngjashme me Shoqërinë, në Shqipëri ose jashtë saj;
- (iii) të kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi;
- (iv) të kryejë aktivitete import - eksporti të mallrave dhe/apo shërbimeve;
- (v) të kryejë aktivitete për shitjen me pakicë apo shumicë të mallrave, pajisjeve siç do të konsiderohet e përshtatshme



- (vi) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.
3. Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj të aktivitetit dhe/ose që lidhet me objektin e saj.
4. Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse në Republikën e Shqipërisë dhe standardet më të mira etike.

#### IV. Statuti

Ortaku i Vetëm deklaron miratimin dhe zbatimin e Statutit të Shoqërisë. Aktiviteti dhe veprimtaria e Shoqërisë do të kryhen në përputhje me Statutin e së Shoqërisë dhe rregullat e detyrueshme të legjislacionit shqiptar.

#### V. Kapitali

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është ALL 100.00 (njëqind lekë), i ndarë në 1 (një) kuotë të zakonshme me vlerë nominale ALL 100.00 (njëqind lekë), plotësisht i nënshkruar dhe i pashlyer, i zotëruar plotësisht nga ortaku i vetëm i Shoqërisë:

- **Z. Dritan Skënderaj**, shtetas shqiptar, lindur më 14/04/1982, në Ninësh, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I20414130E, zotëron të gjithë kapitalin e Shoqërisë të barabartë me ALL 100.00 (njëqind lekë), i përbërë nga 1 (një) kuotë i barabartë me ALL 100.00 lekë.

#### VI. Administratori

Administratori i Shoqërisë është:

- **Z. Bledar Ymeraj**, shtetas shqiptar, lindur më 22/01/1979, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H90122040T.

Administratori emërohet për një afat në detyrë prej 3 (tri) vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

#### VII. Autorizimet

Ortaku i Vetëm autorizon **Znj. Ana Goro**, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. I55303082E dhe/ose **Znj. Juna Rexha**, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. J86225060S, bashkërisht ose individualisht, të hartojnë, nënshkruajnë, ekzekutojnë dhe dorëzojnë në emër të Shoqërisë çdo dokument të nevojshëm për të plotësuar dhe bërë efektiv regjistrimin e **Go Green Poçem Sh.p.k.**, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, dhe çdo autoriteti kompetent tjetër siç kërkohet me ligj.

*Akti i Themelimit është hartuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.*

#### ORTAKU I VETËM

DRITAN SKËNDERAJ

